



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 482 prot.

Memaliaj më 27.01. 2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 27. 01. 2025 në sallën e mbledhjeve të këshillit në katin e parë të bashkisë Memaliaj.

Mbledhja drejtohet nga kryetari i këshillit bashkiak z. Erjon Sinanaj.

Mbledhja fillon në orën 10:00

Këshilltarë të pranishëm 8, këshilltarë në momenton e fillimit të mbledhjes.

Të pranishëm: kryetari i bashkisë z. Albert Malaj, drejtori i financës dhe specialist të administratës.

- Pika e parë e rendit të ditës. Njohja me rendin e ditës.

Votohet unanim.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.12.2024.
3. Informacion mbi vendimet e marra në mbledhjen së datës 23.12.2024
4. **Projekt vendim:** “Për miratimin e kriterëve ,procedurave,dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor”.
5. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për periudhën 1-31 Dhjetor 2024”.
6. **Projekt vendim:** “Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastër”.
7. **Projekt vendim:** “Për caktimin e vendeve , për kampera dhe parkim makinash”.
8. **Projekt vendim:** “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 (Paketa Fiskale) Bashkia Memaliaj” .
9. **Projekt vendim:** “Mbi përfitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës në zona banimi me mungesë shërbimesh ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme”.
10. **Projekt vendim:** “Për pasqyrimin e detyrimit financiar për subjektin Margarita Sh.p.k që rrjedhë nga kontrata me datë 01.09.1997 me objekt: “Sipërmarrjen e mirëmbajtjes së siperfaqeve të gjelbëruara, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dekorit” në peridhën 01 Janar-31 Tetor 2002 ne vleren 3,200,000 (tre million e dyqind mije) lekë”.

- 11. Projekt vendim:** "Për miratimin e listës emërore për vlerën maksimale të subvencionimit të qirasë në treg të lirë 2025".
- 12. Projekt vendim:** "Për kufijtë e financimit dhe miratimin e listës së familjeve përfituese për projektin e strehimit në vitin 2025 (përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese) për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara nga Bashkia Memaliaj".
- 13. Projekt vendim:** "Për miratim nivelit të pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera (rishqyrtim)".
- 14. Projekt vendim:** "Për dhënie titull Qytetar nderi Znj. Hako Sadik Hyseni (Ahmetaj)".
- 15. Projekt vendim:** "Për dhënie titulli Qytetar Nderi" Z. Hyso Myftar Hysaj".
- 16. Projekt vendim:** "Për emërtim rruge".
- Pika e dytë: "Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.12.2024"
- Votohet unanim.
- Pika e tretë : Informacion mbi vendimet e marra në mbledhjen së datës 23.12.2024.
 - Pika e katërt: **Projekt vendim:** "Për miratimin e kriterëve ,procedurave,dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor".
- Relaton Laora Hoxha/specialiste sipas relacionit bashkangjitur.
- Edmonda Harizi: A mund të shtojmë më kriterë për të përfituar nga fondi i bashkisë?
- Laora Hoxha: Janë të përcaktuara sipas ligjit dhe kalojnë në parim.
- Flamur Mushamati: Bashkia jonë ka nivel të ulët ekonomik dhe ka shumë familje në vështirësi ekonomike.
- Vjen në mbledhje Taulant Rama.
- Hidhet në votim.
- Vota Pro 9 Vota.
- Vota Kundër 0 Vota
- Vota Abstenim 0 Vota. Miratohet.
- Pika e pestë: **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për periudhën 1-31 Dhjetor 2024".
- Komisioni i financave: Ne u mbledhëm dhe diskutuam, ishin hequr 4 familje, shkak na u tha ishte mungesa e fondit.
- Erjon Sinanaj/ Kryetar këshilli: A ka ardhur fondi për muajin janar?
- Laora Hoxha: Për janarin nuk ka ardhur akoma fondi.
- Hidhet në votim.
- Vota Pro 9 Vota.
- Vota Kundër 0 Vota
- Vota Abstenim 0 Vota. Miratohet
- Vjen në mbledhje Irena Jaupi.
- Pika gjashtë " **Projekt vendim:** "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastër".
- Relaton Laora Hoxha/specialiste sipas relacionit bashkangjitur.
- Erjon Sinanaj: Dua të di për procedurën ? A ka kriterë?
- Laora Hoxha: Po ka kriterë ,të jetë në moshë e pensioni , të jetë i vetmuar etj.
- Hidhet në votim.
- Vota Pro 9 Vota.
- Vota Kundër 0 Vota
- Vota Abstenim 0 Vota. Miratohet.

●Pika shtatë **Projekt vendim:** “Për caktimin e vendeve , për kampera dhe parkim makinash”.
Komisioni Arsola Muzha: Ne si komision u mbledhëm dhe patëm mendim të vinin si dy projekte vendime të ndara.

- Kamperat ishin menduar të fusha e 1 Majit ,nuk ishim dakord sepse ajo fusha përmbytet. Nuk na duket e përshtatshme.

- Parkimi me pagesë ,edhe për këtë nuk jemi dakord për t’u bërë me një sens dhe me pagesë sepse një qytet si Memaliaj dihet gjendja ekonomike.

Relaton Znj.Leonora Mici /shefe e urbanistikës ,sipas relacionit bashkangjitur.

A.Malaj/Kryetari i bashkisë:Duke studiuar lumin 10 vitet e fundit nuk ka ndodhur ngritje e nivelit të lumit për shkak se lumi ka lëviyur në anën e Kallëmbit dhe ngrohjes globale.Ne e kemi vendosur për vendqëndrim gjatë verës. Nëse do të investojmë do të bëhet studim .

Arsola Muzha: Fusha e sportit ka qenë më lartë.

Vjen në mbledhje Bujar Mamaj.

Esmerald Xhemali:Unë evotova herën e kaluar kundra paketën fiskale kundra për këta 2 zëra . Na vjen këtë herë një p/vendim me këta zëra dhe futen dhe në paketën fiskale. Përsa I përketë vendqëndrimit të kamperave. Çfarë statusi ka në hipotekë?

-Leonora Mici: Është tokë shtet,pronë e bashkisë.

Taulant Rama: Unë mendoj se duhet të diskutojnë ,a duhet apo jo.Pra ne do t’u japim leje dhe pastaj do të vine me një studim të detajuar.Edhe unë mund të jem kundër por a e do qyteti këtë pra nuk ka vend për diskutim ,a më pëlqen a nuk më pëlqen mua.Vjosa është zonë e mbrojtur do të marrin leje të tjera .Ne e çelim vetëm si procedure.

Albert Malaj/Kryetari i bashkisë: Në çdo qytet paguhet për ambientet publike dhe ne duhet të mbledhur të ardhura për të mbajtur pastër ambientin e përbashkët.Nëse do të investojmë për kamperat do të marrim leje në institucionet përkatëse.

Erjon Sinanaj/Kryetari i këshillit:Kjo duhej të vinte në dy p/vendime të ndara.Unë propozoj ti votojmë të ndara. Jeni dakord t’i votojmë veç e veç.Unë dhashë një mendim e shoh që nuk ka diskutim dhe se morët parasysh.

Albert Malaj: Para se të vendosni dua t’ju bëj me dije se nga takimi me drejtorin e FSHZH , kam marrë fjalën paraprakisht për një investim të ngjashëm i cili është bërë në bashkinë Belsh dhe ka qenë shumë fitimprurës.

Kryetari i këshillit : Ju ftoj ta votoni të ndarë dhe pandryshime në formulim.

Vota Pro 9 vota

Vota Kundër 2 vota E:Xhemali , A Muzha.

Vota Abstenim 0 vota.

Hidhet në votim vendcaktimi i kamperat.

Bujar Mamaj: Të caktohet të taksohen përgjatë gjithë luginës së Vjosës.

Taulant Rama:Jam dakord , meqë ne i ndamë, mendoj të shihet si një obsion i përkohshëm , ne I japim leje të caktojnë një vend.

Asqeri Muçoima:E kam thënë disa herë që saktësia e dokumentacionit lë për të dëshiruar. Zoti kryetar e përmendët disa e përkohshëm dhe këtu se keni shkruajtur.

Albert Malaj:Profesor si do bëjmë kur të mos jeni ju më në këshill,kush do të na i korrigjoj gabimet.

Flamur Mushamati: Po diskutojmë dhe jemi futur në një rreth vicioz.A do ta votojmë?

Kryetari i këshillit:Ju ftoj ta hedhim në votim ne vendcaktimin e kamperave.

Erjon Sinanaj: Dua të bëhet një studim për vendcaktimin e kamperave.

Vota Pro 4 vota

Vota Kundër 3 vota

Vota Abstenim 4vota. Nuk miratohet.

Kryetari i këshillit:Ju ftoj ta hedhim në votim parkimin e makinave.

Vota Pro 4 vota

Vota Kundër 4 vota

Vota Abstenim 3 vota. Nuk miratohet.

Taulant Rama:Jam shprehur kundër se nuk e di a është marrë mendimi i qytetarëve për këtë p/vendim.

●Pika tetë **Projekt vendim:** “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 (Paketa Fiskale) Bashkia Memaliaj” .

Relaton znj. Klaudia Shehu/përgjegjëse e taksave , sipas relacionit bashkangjitur.

Esmerald Xhemali:Unë si nënkryetar komisioni , meqënëse nuk besoj se do të jem më anëtarë komisioni , dua të bëj një pyetje : A janë marrë parasysh kërkesat e komisionit?

Klaudia Shehu: Nuk janë marrë parasysh kërkesat e komisionit .

Albert Malaj/Kryetar bashkie:Ne kemi bërë një studim por edhe duke u krahasuar me bashkitë fqinje ,tarifat tona janë më të ulta.Duke qenë se nuk kami dashur të vendosim gjoba , kemi vendosur të rrisim tarifën .Nisur nga koseguenca e mbledhjes.A ka ndrzshime në paketën fiskale?

Erjon Sinanaj:Përsa I përket tarifës së kamperave dhe parkimit ,bie tarifa automatikisht.

Asqeri Muçoima: Do të isha dakord , nëse bashkia del garant në heqjen e inerteve sepe dhe banorëve u bie më lirë.

Kryetar i këshillit propozon ta hedhim në votim projekt vendimin me dy ndryshimet që kanë të bëjnë me pikën paraardhëse.

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 2 vota E.Xhemali, A.Muzha.

Vota Abstenim 1 vota. Miratohet.

●Pika nëntë.**Projekt vendim:** “Mbi përfitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës në zona banimi me mungesë shërbimesh ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme”.

Edmonda Harizi:Ishim të pa qartë po elamë të merrnim shpjegime në mbledhje.

Relaton Znj.Leonora Mici, sipas relacionit bashkangjitur.

Asqeri Muçoima:Doja të dija ,kjo marrja e emrave të qytetrëve është e mbështetur në ligj.Çfarë përfitojnë këta banorë?

Leonora Mici: Banorët përfitojnë shtrimin e rrugëve midis pallateve.

Lauresha lila :Mendoj ta hedhim në votim se po e zgjasim diskutimin.

Kryetar i këshillit propozon ta hedhim në votim.

Vota Pro 9 vota

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 2 vota E.Xhemali, A.Muzha.Miratohet.

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 2 vota E.Xhemali, A.Muzha.

Vota Abstenim 1 vota. Miratohet.

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 2 vota E.Xhemali, A.Muzha.

Vota Abstenim 1 vota. Miratohet.

●Pika dhjetë **.Projekt vendim:** “Për pasqyrimin e detyrimit financiar për subjektin Margarita Sh.p.k që rrjedhë nga kontrata me datë 01.09.1997 me objekt: “Sipërmarrjen e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbëruara, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dekorit” në periudhën 01 Janar-31 Tetor 2002 në vlerën 3,200,000 (tre million e dyqind mijë) lekë”.

Relaton Z.Teki Alia/jurist, sipas relacionit bashkangjitur.

Flamur Mushamati: A ka kaluar në process gjyqësor?

Teki Alia: Ka kallëzuar kryetarin e bashkisë për mos pagim të detyrimeve dhe gjykata e ka dënua kryetarin që ka qenë në detzrë për vitet përkatëse.

Asqeri Muçoima : Ju si jurist na jepni shpjegim ligjor të kësaj situatë.

Taulant Rama:Jemi në rastin ku kryetari i bashkisë është dënua sepse nuk ka firmosur situacionet që i kanë sjellë edhe falimentimin kësaj shoqërie.

Edmonda Harizi: Unë jam dëshmitare që ato lekë janë të mbartura.Deri në ç’vit janë kontabilicuar?Arsyen pse janë ndryshuar,tjetërsuar?

Teki Alia: Deri në vitin 2006 , pastaj janë tjetërsuar.

Esmerald Xhemali: Ne si komision e trajtuam dhe kërkuam të sillej një ekstrat sipas periudhave , pasi në komision ishte jurist tjetër.Me sa shoh ,nuk është reflektuar .Unë jam njohur me materialin dhe me sa kam konstatuar është bërë një pa drejtësi e madhe, dëm material e moral.U bëj thirrje këshilltarëve ti njihet ky dëm këtij subjekti.

Flamur Mushamati: Eksperti ka llogaritur edhe kamat vonesat.

Teki Alia: Jo nuk janë llogaritur kamat vonesat.

Taulant Rama:Jam pro të njihet dëmi I Margarita Sh.p.k.

Kryetari i këshillit:Ju ftoj ta votojmë.

Vota Pro 11 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

●Pika njëmbëdhjetë.**Projekt vendim:** “Për miratimin e listës emërore për vlerën maksimale të subvencionimit të qirasë në treg të lirë 2025”.

Relaton Z.Mikel Saliu:/specialist I urbanistikës/sipas relacionit bashkangjitur.

Erjon Sinanaj:Ne duam të shihni me prioritet rastin e Edmond Nanon dhe Asqeri Arapi.

Mikel Saliu: Duhet të kenë një pronësi ose një kontrat qeraje që të përfitojnë në një nga thirrjet.

Kryetari i këshillit:Ju ftoj ta votojmë.

Vota Pro 11 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

●Pika dymbëdhjetë.**Projekt vendim:** “Për kufijtë e financimit dhe miratimin e listës së familjeve përfituese për projektin e strehimit në vitin 2025 (përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese) për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara nga Bashkia Memaliaj“.firma fituese është duke kryer punimet.

Erjon Sinanaj: Duhet ta di si po ecin banesat e vitit të kaluar.

Mariglent Dervishi:Jemi akoma në proces .

Arsola Muzha:Dua të shoh të gjitha dosjet për shkak transparence.

Albert Malaj:Është hapur thirrja të gjithë kanë të drejtë të aplikojnë .Komisioni ka bërë një krehje sipas kriterëve.Ministria s’ka vendosur numër të caktuar për aplikim. Pastaj ,kush fiton I cakton ministria.

Erjon Sinanaj:Nga këta 112 që janë përfshirë a ka të tjerë që kanë ngelur jashtë kësaj liste?

Mikel Salia: janë dhe kat[er] emra që I kanë plotësuar dokumentat pasi është protokolluar p/vendimi.
Esmerald Xhemali: 1.Duhet të ishim vënë në dijeni për shtimin e këtzre emrave në listë.

2. Kam vrejti për listen nuk ka atësi dhe vendbanim.

Bujar Mamaj: Ka shumë njerëz nevojtarë në bashkinë tone, po ta shkelësh zonën ka akoma më nevojtarë. Nuk duhet të punojmë me dy standard.

Asqeri Muçoima: Dokumentat vine në fund dhe ne nuk arrijmë të shqyrtojmë materialet.

Largohet Irena Jaupi.

Flamur Mushamati: Jam dakord, por unë u kam dhënë informacion banorëve të zonës time, por kanë hasur problematikë sepse nuk kanë pasur dokumentacion.

Erjon Sinanaj: Ju ftoj nëse keni emra që janë nevojtar dhe nuk janë future në listë, ti shtojmë.

Albert Malaj: Dosjet sot janë mbyllur sepse janë shumë dokumenta që duhen plotësuar për një aplikant.

Taulant Rama: Do kalojmë dosje më dosje? Unë kam qenë që vitin e kaluar kam debatuar, por sivjet e dinim të gjithë për aplikimin. Nëse do t'i trajtojmë rast pas rasti. Ne e dime hallet e komunitetit dhe mentalitetin e mbajtjes së dokumentacionit. Mund të ketë problem dokumentash. Do të shtojmë, po kë do të shtojmë?

Edmonda Harizi: A ka aplikime të tjera?

Hidhet në votim lista duke shtuar edhe emrat:

1. Dallëndyshe Gjoni

2. Sejat Pushi

3. Selvi Malka

4. Margarita Lala

5. Liri Skënderi

6. Besnik Merko

7. Shahin Likometi

8. Aurora Harizi

Vota Pro 10 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

● Pika trembëdhjetë. **Projekt vendim:** "Për miratim nivelit të pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera. (rishqyrtim).

Vjen në mbledhje Irena Jaupi.

Relaton Xhuvana Kuçi / jurist sipas relacionit bashkangjitur.

Edmonda Harizi: A ka ndikim në buxhet?

Xhuvana Kuçi: Nuk ka nevojë për ndryshime në buxhet për shkak të vakancave në strukturë.

Kryetari i këshillit fton këshilltarët ta votojnë.

Vota Pro 10 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 1 vota. E: Xhemali. Miratohet.

Kryetari i këshillit propozon të kalohen në bllok.

● Pika katërmëdhjetë. **Projekt vendim:** "Për dhënie titulli Qytetar nderi Znj. Hako Sadik Hyseni (Ahmetaj)".

● Pika pesëmbëdhjetë. **Projekt vendim:** "Për dhënie titulli Qytetar nderi" Z. Hyso Myftar Hysaj".

● Pika gjashtëmbëdhjetë. **Projekt vendim:** "Për emërtim rruge".

Asqeri Muçoima: Po japim tituj nderi vend e pavend dhe pa ndonjë kontribut të veçantë.

Vota Pro 10 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 1 vota. A. Muçoima. Miratohet

E. Xhemali: Kam një pyetje, a na lejohet neve për anulimin e vendimit që është marrë nga dikush që është nën akuzë dhe është "Qytetar nderi" i Bashkisë Memaliaj.

Taulant RamaË UNë si kryetar I komisionit ,pot ë them se nuk kemi të drejtë ne të heqim titujt e dhënë aq më tepër që në këtë rast nuk është dënuar por akuzohet .


Kryetari I këshillit e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës.

1. Irena Jaupi
2. Esmerald Xhemali
3. Arsola Muzha
4. Maltona Bërxihi
5. Lauresha Lila
6. Asqeri Muçoima
7. Taulant Rama
8. Bujar Mamaj
9. Edmonda Harizi
10. Flamur Mushamati
11. Erjon Sinanaj

Sekretari i Këshillit

Erjola Allka



Kryetari i Këshillit

Erjon Sinanaj

